



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS**  
**СКУПШТИНА КОСОВА**  
**ASSEMBLY OF KOSOVO**

**Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri,  
Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion**

Mbledhja e dt. 26.07. 2007

Salla: C.301 ora 10.00

Ndërtesa e Kuvendit të Kosovës.

**Procesverbal**

Morën pjesë: Ibush Jonuzi - kryetar, Bajrush Xhemali, Mahir Yagcillar, Hatixhe Hoxha, Ilmi Ahmeti, Sale Berisha, Milazim Haliti, Brikena Kryeziu, Xhevdet Neziraj ndërsa munguan: Sllagjan Iliq, Zef Morina, Ylber Hysa, Fadil Gashi, Të ftuar Ministri i MEM-it (z. Ethem Çeku me bashkëpunëtor), drejtori i KPMM-së (z. Azem Rexhaj me bashkëpunëtorë) dhe Victor Ulaj, këshilltar i kryeministrit.

Mbledhjen e drejtoi Ibush Jonuzi – kryetar i Komisionit, me këtë

**Rend dite**

1. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara;
2. Kahet e strategjisë zhvillimore të NSH “Trepça”
3. Të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua.

- 1. Procesverbali u miratuan pa vërejtje.**
- 2. Kahet e strategjisë zhvillimore të NSH “Trepça”**

**Ibush Jonuzi** kryetar i komisionit, e arsyetoi rishtruarjen në rend të ditës edhe kësaj radhe, situatën e përgjithshme dhe paralajmërimet për kahet zhvillimore të “Trepçës”. Komisioni, disa here me radhë, që nga viti i kaluar ka debatuar për “Trepçën” duke kërkuar format e zgjidhjes dhe të përcaktimit të statusit të ardhshëm juridik të “Trepçës”. Ka paralajmërimet se “Trepça” e menaxhuar nga AKM-ja –UNMIK-u, gjendet para

përgatitjeve për likuidimin dhe për riorganizimin në pajtim me Rregulloren përkatëse nr. 2005/48.

Institucionet vetëqeverisëse të përkohshme të Kosovës duhet të ndërmarrin hapa konkret këmbëngulës që të parandalojnë likuidimin dhe privatizimin e “Trepçës” tha Ibush Jonuzi dhe kërkoi nga të pranishmit (përfaqësues të MEM-it dhe të KPMM-së ) e ftuar që të informojnë Komisionin për planet strategjike zhvillimore dhe për masat e Qeverisë – Ministrisë, për parandalimin e privatizimit të plotë të “Trepçës”.

**Ethem Çeku**, ministër i MEM-it, informoi të pranishmit se MEM-i është në përfundim të hartimit dhe të miratimit të Strategjisë zhvillimore të minierave në Kosovë.

strategjia përfshin përshkrimin e gjendjes ekzistuese të minierave, potencialin ekonomik, analizat e aftësisë konkurruese, objektivat strategjike, masat dhe politikat afatmesme dhe ato afatgjata.

Objektivi kryesor është: sigurimi i legjislacionit përkatës, sigurimi i ambientit të përshtatshëm për investitor , zhvillimi i sektorit minerar në pajtim me standardet evropiane, planifikimi dhe zhvillimi i sektorit minerar në pajtim me planin nacional e tjera.

Përkundër faktit se “Trepça” është nën administrimin e AKM-së, nga Buxheti i Kosovës janë investuar mbi 70 milion euro mjete financiare për mirëmbajtje elementare të disa minierave.

Trepça vlerësohet se i ka rreth 53 milionë tonë rezerva të xeheve. Vlera e përgjithshme minerare e “Trepçës” është mbi 9.8 miliard euro. Po të eksploatoheshin minierat ekzistuese të Trepçës, vlerësohet se të ardhurat vjetore për buxhetin e Kosovës dot ishin rreth 500 milion euro. Për ri ngritjen e “Trepçës” nevojiten rreth 177 milion eurove.

Sipas **Shyqyri Kelmendit**, këshilltar i ministrit, tani në “Trepçë” punojnë 507 punëtorë që janë të angazhuar më tepër në mirëmbajtje, punohet me licenca të kufizuara, miniera e Artanës më se dy vjet është në përgatitje për prodhim por ende nuk e ka filluar prodhimin. Disa miniera kanë licencë për hulumtime por kanë filluar të merren edhe me prodhim si miniera në Cërnac dhe Belloberd. MEM-i planifikon që t’i riaktivizojë sa më parë edhe minierat si janë në: Stantërg, Artanë, Hajvali, Badoc, Melenicës, Ziaçës. MEM-i planifikon edhe zhvillimin e industrisë kimike për prodhimin e plehrave artificiale.

Të gjitha këto projekte mund të mbetën në letër nëse “Trepça” likuidohet dhe privatizohet. Mosshpallja nga PSSP-ja e legjislacionit për miniera, i miratuar nga Kuvendi i Kosovës, si dhe menaxhimi i “Trepçës” nga AKM-ja, janë pengesat kryesore të jetësimit të politikave strategjike për “Trepçën”.

**Naip Zeka** përfaqësuesi i Bordit të KPMM-së tha se duhet bashkërenditur aktivitetet për të përcaktuar zgjidhje më rentabile duke përmendur partneritetin me investitorët e huaj.

**Viktor Ulaj** këshilltar i kryeministrit tha se para se të behet strategjia zhvillimore e minierave, duhet zgjidhur a ndërruar statusin juridik të “Trepçës” nga NSH në NP ose formë tjetër juridike. Nëse “Trepça” mbetet me status të NSH edhe pas zgjidhjes së statusit juridik e politik të Kosovës gjasat janë të vogla që Trepça të menaxhohet nga Institucionet e Kosovës. Janë bërë parapërgatitjet formale që NSH “Trepça” të likuidohet dhe përmes kësaj forme të bëhet privatizimi i saj. Kërkesat e kreditorëve dhe ato për borxhe të tjera, sipas një para llogarie jozyrtare sillen rreth 70 milionë euro.

Sipas **Bajrush Xhemailit**, anëtar i Komisionit, një pjesë të fajit për situatën në të cilën gjendet “Trepça” përveç AKM-së e kanë edhe anëtarët vendorë të Bordit të AKM-së . Ai përgëzoi MEM-in për angazhim në fushën e minerareve.

Në vazhdim edhe anëtarët e tjerë të Komisionit parashtruan pyetje dhe bënë kritika ndaj Qeverisë për mosveprim të organizuar dhe me kohë, si dhe dhanë sugjerime se si të veprohet.

- Komisioni si dhe përfaqësuesit e tjerë të Institucioneve u dakorduan se Qeveria duhet paraprakisht t’i marrë përsipër të gjitha borxhet e “Trepçës” ndaj kreditorëve të mundshëm dhe të tjerëve pa marrë parasysh shumën financiare dhe kur sesi të mos lejohet likuidimi dhe privatizimi i “Trepçës”.
- Në fund Komisioni u pajtua që të hartojë dhe ta propozojë një akt-rezolutë, për Kuvendit e Kosovës lidhur me veprimet e mëtejme të institucioneve të Kosovës rreth zgjidhjes dhe definimit të statusit juridik të “Trepçës”, me qëllim të përjashtimit të mundësisë së zhvillimit të procedurave të privatizimit të saj.

### **3. Të ndryshme:**

-Të martën me 31.08.2007 mbahet mbledhje përsëri me të njëjtin rend dite ku pritet të miratohet rezoluta përkatëse.

Kryetari i Komisionit

Ibush Jonuzi